

FJALA E DEPUTETES MILVA EKONOMI

E ENJTE 14 PRILL 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të nderuar qytetarë,

Unë do ta filloj fjalën time duke iu drejtuar të gjithëve, se ne jemi të gjithë dëshmitarë të raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, që doli para pak kohësh, por ne, ndryshe nga opozita, që e keqpërdor këtë raport, i bëjmë një lexim shumë të kujdesshëm, siç bëjmë përherë kur kemi raporte ndërkombëtare, sepse duhet t'i shënojmë me kujdes detyrat tona për të ardhmen. Ne i lexojmë me kujdes që t'i kthejmë në një platformë veprimi, por të mos harrojmë së në këtë raport ndërkombëtar të DASH-it në mënyrë shumë specifike për të drejtat e njeriut thuhet që vlerësohen përpjekjet, që bëjnë autoritetet shqiptare për të luftuar korrupsionin, fenomen që nuk lindi me ardhjen PS-së në pushtet, por është një fenomen i kahershëm i shoqërisë që luftohet përditë dhe është një betejë që po e kryejmë.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh që ky Departament në raportin e tij i kushton shumë vëmendje luftës që po bën qeveria shqiptare për të pastruar sistemin e drejtësisë. Ndaj, ai e vlerëson të gjithë përpjekjen tonë për të zbatuar vetingun dhe thotë se deri në shtator kanë dështuar dhe janë shkarkuar 42% e gjyqtarëve dhe e prokurorëve të verifikuar; 36% e kanë kaluar dhe 22% kanë dhënë dorëheqjen nga detyra. Praktikata e ndjekura deri tani i kanë shërbyer funksionimit më të mirë të shtetit të së drejtës. DASH-i vlerëson shumë përpjekjen e Policisë së Shtetit për ngritjen dhe funksionimin në mënyrë të pavarur të Agjencisë së Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Policinë e Shtetit, e cila merret një për një me rastet e abuzimit të çdo punonjësi të Policisë së Shtetit. Për këtë arsye qeveria shqiptare këtë raport do ta shikojë me shumë kujdes, sikurse çdo raport tjetër ndërkombëtar.

Qeveria shqiptare nuk kujdeset vetëm për këtë lloj raporti, por dëgjon edhe zërin e qytetarëve. A ju kujtohet që pak kohë më parë kemi sjellë në Kuvend ligjin "Për bashkëqeverisjen" dhe dialogimin me popullin? Ndërkohë, pala e opozitës e konsideroi si një ligj që nuk do të bënte punë, por, në fakt, koha tregoi se bashkëqeverisja ishte një formë e dëgjimit të zërit të popullit, pavarësisht ngjyrës politike që preferojnë individët në Republikën e Shqipërisë, të majtë apo të djathtë, për ta ndihmuar administratën tonë publike që të jetë më e zhdërvjelltë dhe më afër zgjidhjeve të problemeve që kishin. Dëgjimi i këtij zëri krijoi edhe një mundësi tjetër: bëri një presion pozitiv për ngjarjet e reja në administratën publike shqiptare. Ne jemi dëshmitarë që administrata publike shqiptare ka sot më shumë shërbime online për qytetarët. Vetëm me një klik, pa paguar asgjë, qytetarët shqiptarë marrin më shumë shërbime.

Për t'ju sjellë në vëmendje, dy ditë më parë Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim botoi një raport vjetor që quhet "Përditësimi i sistemeve dhe shpërndarja e benefiteve të digjitalizimit", ku evidentoi edhe një herë vëmendjen e veçantë që qeveria shqiptare u jep atyre që quhen "Mundësues të shërbimeve digjitale". Në fakt, në këto mundësues të shërbimeve digjitale, ku Shqipëria kishte bërë një

progres të pakrahasueshëm, numri i shërbimeve qeveritare në harkun kohor të një 5- vjeçari ishte rritur më shumë se 40%. Të gjithë jemi dëshmitarë se së fundi kemi dy shërbime të reja online, që datojnë në muajin që lamë pas. Shërbimi i parë është “Raporte mjekësore”, ku mënyra e përfitimit të raporteve pa të drejtë tashmë kontrollohet nga mjeku i familjes dhe midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Gjithashtu, dje qeveria shpalli një program tjetër digjital, që është në fazën e dytë, “e-Bileta”. Kjo gjë e ndihmon më shumë sektorin e transportit që të ketë mundësi të operojë me bileta, që janë në një sistem fiskal të mbyllur. Kur erdhi ky shërbim i ri? Erdhi pikërisht në çastin kur qeveria deklaroi se do të ishte një qeveri e përgjegjshme, në përkujdesje të popullatës shqiptare, në një moment kur çmimet e produkteve të shportës dhe të shërbimeve bazë të qytetarëve u rritën.

Siç jua kemi thënë, qeveria vuri në dispozicion një fond për të gjitha agjencitë e transportit, në mënyrë që të punësuarit që lëvizin në tregun e punës qoftë në zonat urbane, qoftë në zonat rurale, të mos penalizohen nga rritja e çmimit të karburantit. Për këtë arsye platforma e “e-Bileta” i vjen në ndihmë pikërisht angazhimit që mori qeveria për të qenë afër popullatës dhe për të treguar përkujdesje. Ne nuk tregojmë përkujdesje vetëm në këto forma. E kuptojmë se kjo situatë nuk është e lehtë, e kuptojmë shumë mirë që është një situatë e vështirë dhe duhet dëgjuar zëri i të gjithëve, pavarësisht krahut politik nga vjen. Gjithashtu, kjo histori nuk i takon vetëm Shqipërisë, por të gjithë Europës dhe të gjithë së bashku mund të dalim nga kjo situatë e vështirë vetëm duke menduar për programe zhvillimi afatmesme ose afatgjate. Në këtë koncept erdhi edhe Këshillimi Kombëtar, si një mundësi shumë e mirë që çdo qytetar shqiptar të tregonte idenë që kishte për Shqipërinë e së nesërme. U dhanë përgjigje nga më shumë se gjysmë milioni shqiptarë. Për këtë shërbim nuk u kërkua kartë identiteti, të dhënat ishin konfidenciale dhe duhet të përgjigjeshin vetëm të rriturit mbi 18 vjeç. Shqiptarët dhanë mendimet e tyre për të ardhmen e afërt, sidomos për gjëra që kishin të bënin me sigurinë sociale.

Shqiptarët dhanë përgjigje pozitive për të gjitha nënat me fëmijë të mitur dhe për ato me shumë fëmijë të mitur u kërkua të merren masa për t’i ndihmuar. Shqiptarët dhanë përgjigje pozitive për të ndihmuar moshën e tretë, që pensionistët, të cilët punojnë ende për të rritur të ardhurat e tyre në familje, të mos vazhdojnë të paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore. Shqiptarët penalizuan bizneset e mëdha, që nuk janë gati, të mos japin paga abuzive për punonjësit e tyre, duke hequr dorë një herë e përgjithmonë nga ajo që ne e quajmë “skllavëria e shekullit të ri”, sepse të gjithë duhet të kenë mundësi të garantojnë të ardhmen e tyre. Shqiptarët morën përsipër të kenë angazhim edhe për sa i takon mjedisit, të dënojnë të gjithë ata që prishin mjedisin. Ne e dimë shumë mirë që atdheu ynë duhet të mbahet i pastër, por kjo përgjegjësi është jona dhe e brezave të ardhshëm. Shqiptarët treguan dijet e tyre edhe për sa u përket ngjarjeve të politikës ndërkombëtare. Gati 60% e të pyeturve që dhanë përgjigje në Këshillimin Kombëtar ishin pro “Ballkanit të hapur”.

Ne të gjithë e dimë pse, pasi e shikojmë që të dhënat nga tregtia e jashtme, nga mundësia që ka Shqipëria për të ngritur një ekonomi të hapur, dëshmojnë për një rritje ekonomike, dhe sa më shumë të ndodhë rritja ekonomike në Shqipëri, aq më shumë do të përkthehet në buxhetet familjare. Të mos harrojmë se në momentet që flasim qeveria ka marrë disa masa për t’u ardhur në ndihmë shqiptarëve me paketën e rezistencën sociale. Janë rritur pagat minimale, për t’u dhënë mbështetje në një kohë kur inflacioni në Shqipëri është duke u rritur, sikurse në çdo vend tjetër të botës, sidomos për atë grup shpenzimesh që ka të bëjë me ushqimet dhe transportin. Gjithashtu, Shqipëria mori përsipër të bëjë

kujdes dhe të ketë vëmendje edhe për klasën e mesme, jo vetëm për personat me pagë minimale dhe punonjësit e familjeve në nevojë, duke bërë kujdes në klasifikimin e tatimeve për pagat 40-50 mijë lekë të rinj në muaj dhe më shumë se kaq. Ne sot mund të themi me gojën plot se 56% e të punësuarve e kanë zero tatimin për pagën.

Dua të them se ne bëjmë shumë mirë që dëgjojmë raportet ndërkombëtare, por nga ana tjetër, duhet t'i përkthejmë këto në aksione, në kushtet reale në të cilat ndodhet vendi. Ne e dimë shumë mirë që ky mandat nuk është i lehtë, është një mandat pune, ndaj kemi nevojë të dëgjojmë zërin e gjithkujt për t'i arritur këto gjëra. Zëri i gjithkujt nuk është vetëm zëri i elektoratit të majtë, por zëri i të gjithë shqiptarëve. Nuk ka rëndësi forca politike për mënyrën se si ne mendojmë të zgjidhim problemet, por mënyra se si ne mendojmë për të çuar përpara vendin, pa dyshim, u takon të gjithë individëve të Republikës. Unë besoj se masat e marra nga qeveria, ky zë që qeveria po u kushton qytetarëve të saj, janë mënyra më e mirë për të përballuar krizën, e cila duhet të na bëjë edhe më të ndërgjegjshëm, se në fund të saj do të dalim më të fortë, duke menduar se e ardhmja është këtu, duke menduar se Shqipëria ka nevojë të përdorë burimet strategjike që ka dhe inovacionet që ka filluar të zhvillojë sot. Faleminderit!